

Vendim nr. 156 datë 10.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 10.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (K) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket

KËRKUESE: KONXHE XHAJA (LAKRA)

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1699, datë 24.04.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 18, 43, 44, 49, 107, 131, pika 1 dhe shkronja “f”, 134, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Konxhe Xhaja (Lakra) (*kërkuesja*), me urdhrin nr. 1097, datë 28.07.2008 të ministrit të Mbrojtjes fillimisht është marrë në punë me kontratë si zëvendësuese në detyrën specialiste në sektorin e analizës, prognozës e kontabilitetit në Drejtorinë e Planifikimit, Programimit dhe Buxhetimit në Ministrinë e Mbrojtjes. Në datën 10.11.2008 kërkuesja është

emëruar në detyrë si specialiste në sektorin e planifikimit buxhetor në Drejtorinë e Planifikimit, Programimit e Buxhetimit, duke u konfirmuar edhe si nëpunëse civile në këtë pozicion.

2. Për shkak të ristrukturimit të Ministrisë së Mbrojtjes kërkuesja, në vitin 2010, ka kaluar në pozicionin e specialistes në sektorin e zbatimit të buxhetit në Drejtorinë e Planifikimit e Programimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse. Ndërsa në vitin 2013, përsëri për shkak të ristrukturimit të institucionit, ka kaluar në pozicionin e specialistes në sektorin e zbatimit të buxhetit në Drejtorinë e Financave në Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Në datën 30.05.2013 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (*ligji nr. 152/2013*), i cili parashikonte datën 1 tetor 2013 për hyrjen në fuqi (*neni 72*). Hyrja në fuqi e këtij ligji sillte si pasojë shfuqizimin e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (*ligji nr. 8549/1999*) dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me të (*neni 70*). Gjatë kohës që pritej hyrja në fuqi e ligjit, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”” (*akti normativ nr. 5/2013*), me qëllim shtyrjen në kohë të efekteve të ligjit nr. 152/2013. Akti normativ ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 159, datë 30.09.2013. Më tej, ai është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 161/2013, datë 17.10.2013 (*ligji nr. 161/2013*).

4. Në datën 01.11.2013 Kryeministri ka miratuar urdhrin nr. 205 “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 94, datë 30.04.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, të ndryshuar” (*urdhri nr. 205/2013*), nëpërmjet të cilit kanë ndodhur ndryshime strukturore që kanë përfshirë edhe drejtorinë pranë së cilës kërkuesja ka qenë e emëruar.

5. Me shkresën nr. 5384 prot., datë 06.12.2013, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes (*sekretari i përgjithshëm*) i ka propozuar kërkueses kalimin në listëpritje, pasi për shkak të riorganizimit të sektorëve dhe shkurtimit të përgjithshëm të numrit të punonjësve ishin në pamundësi për të ofruar një pozicion të të njëjtit nivel ose nivel më poshtë. Në vijim të kësaj shkrese, kërkuesja i ka kërkuar sekretarit të përgjithshëm rivlerësimin e pozicionit të saj për shkak të natyrës specifike të punës si financiere prej më shumë se 25 vjetësh.

6. Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, me vendimin nr. 80, datë 08.01.2014, ka vendosur të kalojë kërkuesen në listëpritje, duke filluar nga data 10.01.2014, për shkak të ristrukturimit, bazuar në urdhrin nr. 205/2013.

7. Duke mos qenë dakord me veprimet për nxjerrjen në listëpritje, kërkuesja në datën 27.01.2014 i është drejtuar me ankesë sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes. Ndërsa, në datën 14.02.2014 i është drejtuar me ankim Komisionit të Shërbimit Civil. Nga materialet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që këto institucione t'i kenë kthyer përgjigje kërkueses.

8. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014, ka shfuqizuar aktin normativ nr. 5/2013 dhe ligjin nr. 161/2013, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Ky vendim ka hyrë në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 26.02.2014.

9. Kërkuesja në datën 23.06.2017 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 80, datë 08.01.2014 të sekretarit të përgjithshëm për kalimin në listëpritje të saj dhe kthimin në vendin e punës ose në një pozicion pune të barazvlefshme me të ose në një pozicion më të ulët, si dhe detyrimin e palës së paditur për t'i paguar pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

10. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3498 (80-2017-3567), datë 18.09.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi akti i nxjerrë nga sekretari i përgjithshëm nuk plotësonte kushtet për të qenë akt administrativ dhe nuk mund të disponohej mbi të duke iu referuar dispozitave ligjore që rregullojnë shfuqizimin e akteve administrative, sipas nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative (*KPA*). Ndërsa pretendimet e tjera lidhur me ligjshmërinë e ristrukturimit, gjykata nuk i ka marrë në analizë, pasi lidheshin me pavlefshmërinë relative.

11. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 582, datë 07.12.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3498 (80-2017-3567), datë 18.09.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke arsyetuar, se akti i sekretarit të përgjithshëm është akt administrativ, por jo absolutisht i pavlefshëm, pasi ka dalë në përputhje me ligji.

12. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs kërkuesja, duke kërkuar prishjen e vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe pranimin e padisë.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 00-2023-1699, datë 24.04.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi shkaqet e rekursit

haptazi nuk mbështeten në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

14. Kërkuesja në datën 30.05.2023 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkueses

15. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë gjyimit në Gjykatën e Lartë është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

15.1. *Parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme*, pasi trajtimi i kërkueses duhet të ishte sipas ligjit nr. 152/2013 dhe jo sipas ligjit nr. 8549/1999. Për aktet që kanë nxjerrë kërkuesen në listëpritje, nuk është respektuar asnjë procedurë e parashikuar si nga ligji nr. 152/2013, ashtu edhe nga ai nr. 8549/1999.

15.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit dhe të paanshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme, në raste identike, me atë të kërkueses, duke zbatuar ligjin nr. 152/2013. Kërkuesja e kishte parashtruar këtë pretendim, por Gjykata e Lartë është shprehur se në rekurs nuk ngrihen shkaqe që lidhen me praktikën e ndryshme të Gjykatës së Lartë. Mbajtja e qëndrimeve të ndryshme nga i njëjti gjyqtar nuk ofron garanci të mjaftueshme për respektimin e parimit të paanshmërisë.

15.3. *Së drejtës së aksesit substancial*, pasi ka pasur mangësi në drejtim të përgatitjes së dosjes gjyqësore për shqyrtim, duke përfshirë edhe përgatitjen e relacionit të gjyqtarit, si kërkesë ligjore. Kërkuesja nuk ka marrë, marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara në rekurs. Gjithashtu, Gjykata e Lartë duhet ta gjykonte çështjen sipas nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, pasi gjykatat më të ulëta kishin marrë vendime të ndryshme nga praktika e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë lidhur me zbatimin e ligjit nr. 152/2013.

15.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk janë pasqyruar kërkimet dhe argumentet e kërkueses, si dhe pretendimi thelbësor i saj, se vendimet e gjykatave të faktit bien ndesh me

praktikën e Kolegjeve Administrative të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë, ky ka qenë shkaku kryesor i paraqitjes së rekursit, duke iu referuar edhe praktikave të tjera të ndjekura nga Kolegji Administrativ, për sa u përket nëpunësve civilë të Ministrisë së Mbrojtjes.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

16. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individi, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000 mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

17. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht.

18. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që individi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues, do të vlerësohet legjitimiteti i kërkueses, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Kolegji vlerëson se kërkuësja, si individ, legjitimohet në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

20. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individi përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të

njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

21. Qëllimi i këtij kriteri është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Individidi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, kërkuesja në objektin e ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili i ka dhënë fund procesit gjyqësor, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se ajo i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

23. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 24.04.2023 dhe në datën 24.05.2023 i është komunikuar avokatit të kërkueses nëpërmjet adresës së postës elektronike. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës në datën 30.05.2023, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji.

25. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, barazisë përpara ligjit, paanshmërisë, së drejtës së aksesit substancial, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Këto parime e të drejta garantohen nga nenet 4, 18, 42 dhe 43 të Kushtetutës, ndaj *prima facie* hyjnë në kompetencën e Gjykatës dhe do të analizohen në vijim.

26. Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, të barazisë përpara ligjit dhe të paanshmërisë, ndonëse janë paraqitur veçmas nga kërkuesja, bazohen në të njëjtin argument, që lidhet me veprimin në kohë të ligjit për nëpunësin civil, ndaj Kolegji do t'i shqyrtojë së bashku.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike, të barazisë përpara ligjit dhe të paanshmërisë

27. Kërkuesja ka pretenduar se është cenuar parimi i sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme, pasi ndaj saj duhej të zbatohet ligji nr. 152/2013 dhe jo ai nr. 8549/1999. Gjithashtu, qëndrimi i Gjykatës së Lartë se për kërkuesen gjen zbatim ligji nr. 8549/1999 është i ndryshëm nga raste të tjera identike, në të cilat ajo është shprehur se zbatohet ligji nr. 152/2013. Ky qëndrim i Gjykatës së Lartë cenon parimin e barazisë përpara ligjit dhe të paanshmërisë.

28. Kolegji vëren se argumentet për cenimin e parimit të sigurisë juridike, të barazisë së armëve dhe paanshmërisë, në thelb, kërkuesja i ka lidhur me problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, për sa i përket faktit që në raste të njëjta, kjo gjykatë ka vlerësuar se për ato çështje zbatohet ligji nr. 152/2013. Pretendimet e saj lidhen me zbatimin e ligjit në kohë, për të cilat Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se përse në rastin konkret zbatohet ligji nr. 8549/1999 dhe jo nr. 152/2013. Konkretisht, kërkuesja ka paraqitur padi në datën 23.06.2017, duke kundërshtuar për pavlefshmëri absolute aktin e datës 08.01.2014 për largimin nga detyra. Ndërsa vendimi i Gjykatës që ka shfuqizuar ligjin nr. 152/2013 ka hyrë në fuqi në datën 26.02.2014. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se kërkuesja duhet të kishte paraqitur padinë përpara datës 26.02.2014 (*shih paragrafin IIIiii të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*). Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe nga Gjykata e Lartë.

29. Gjykata ka pohuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejtat kushtetuese të individit që vë në lëvizje këtë

Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Po kështu, Gjykata ka pohuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme dhe se ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Gjykata e Lartë i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimin nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimet e referuara nga kërkuesja, sipas së cilës Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga çështja e saj, jo vetëm që nuk janë njësuës për praktikën gjyqësore, por secila nga çështjet gjyqësore është paraqitur për gjykim në kohë të ndryshme, gjë që lidhet me zbatimin e ligjit në kohë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete të paraqitur për shqyrtim përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

32. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese dhe të thelbit të argumenteve, pretendimet e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike, të barazisë përpara ligjit dhe të paanshmërisë, janë haptazi të pabazuara.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial

33. Kërkuesja ka pretenduar se ka pasur mangësi në drejtim të përgatitjes së dosjes gjyqësore për shqyrtim, duke përfshirë edhe përgatitjen e relacionit të gjyqtarit, si kërkesë ligjore. Gjithashtu, kërkuesja, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara në rekurs, për më tepër për pretendimin për mbajtjen e qëndrimeve të ndryshme në raste identike nga Gjykata e Lartë, si dhe duke mos u gjykuar çështja sipas neneve 61 dhe 63 të ligjit nr. 49/2012, i është cenuar dhe e drejta e aksesit substancial.

34. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe të bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Nëse kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që Gjykata e Lartë u jep pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 parashikohen shkaqet e rekursit për të cilat vihet në lëvizje Gjykata e Lartë. Në këtë ligj nuk parashikohet ndonjë procedurë e posaçme për vlerësimin paraprak të pranueshmërisë së rekurseve, për rrjedhojë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 për gjykimin administrativ gjen zbatim neni 480 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Pas kalimit të fazës së seleksionimit paraprak të rekursit sipas nenit 480 të KPC-së, rekursi kalon testin e pranueshmërisë për fazën e dytë, për shqyrtimin e themelit të çështjes, sipas nenit 485 të po këtij kodi ose nenit 63 të ligjit nr. 49/2012. Bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimi i çështjes në Kolegjin Administrativ, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara nga neni 62 i tij, ku shqyrtimi i çështjes kryhet në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në fazën e shqyrtimit të themelit të çështjes zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 61 të ligjit nr.

49/2012, ku, mes të tjerash, parashikohet dhe detyrimi i gjyqtarit relator për të përgatitur relacionin.

37. Duke iu kthyer rastit konkret, kërkuesja në datën 27.12.2022 ka paraqitur rekurs, për të cilin gjyqtari i Gjykatës Administrative të Apelit ka vendosur pranimin. Rekursi, pasi u është njoftuar palëve, është regjistruar në datën 07.02.2023 në Gjykatën e Lartë. Në datën 30.03.2023 është bërë shpallja publike, se çështja do të merrej në shqyrtim nga kolegji seleksionues në dhomën e këshillimit në datën 24.04.2023. Kolegji, pasi ka shqyrtuar rekursin dhe shkaqet për të cilat ishte ushtruar, ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se rekursi nuk ngre problematika që të bëjnë të mendosh se gjykatat më të ulëta kanë gabuar me zbatimin e ligjit material ose procedural dhe se ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Kolegji, në mënyrë të përmbledhur, ka vijuar në arsyetim se vendimi nuk bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe se rekursi i paraqitur për shqyrtim haptazi nuk ngre asnjë shkak nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Një vendimmarrje e tillë nuk cenon të drejtën e aksesit, pasi verifikimi i shkaqeve të rekursit në këtë mënyrë është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj.

38. Për sa më lart, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit substancial është haptazi i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

39. Kërkuesja ka pretenduar se është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk janë pasqyruar kërkimet dhe argumentet e saj, si dhe pretendimi thelbësor se vendimet e gjykatave të faktit bien ndesh me praktikën e Kolegjeve Administrative të Gjykatës së Lartë.

40. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar

si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Në rastin konkret, nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë vërehet se janë pasqyruar palët, vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta, fakti se ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs kërkuesja, duke paraqitur pretendimet e parashtruara në rekurs, mes të tjerave, se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i ndryshëm nga praktika e mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*shih pikën 7 të faqes 2 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se rekursi nuk plotëson kushtet paraprake të pranueshmërisë sipas nenit 480 të KPC-së, pasi shkaqet nuk mbështeten në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Sikurse u analizua, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se në rekurs nuk ngrihen problematika që të bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material ose procedural (*shih paragrafin 37 të këtij vendimi*). Për rrjedhojë, Kolegji, vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë i plotëson standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsytimin e vendimit gjyqësor dhe se pretendimi i kërkueses është haptazi i pabazuar.

42. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.